REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3238/ 7 prot. Datë 20.11.2024

V E N D I M
Nr. 1646/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.11.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "LEON KONSTRUKSION" SHPK, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*", me Nr. REF-20524-09-18-2024 me objekt *"Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave te kontributit të përbashket-materiale mobilimi urban dhe gjelbërimi, Loti 4 (Faza III)*", me fond limit 125,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik "LEON KONSTRUKSION" SHPK, Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "AlbGarden" SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik "LEON KONSTRUKSION" SHPK, me NUIS K71820009I, me adresë: Rruga Diga e

	Liqenit, nr. pasurie 8/312, vol. 25, fq. 40, zona kadastrale 8270, Tiranë.
Autoriteti Kontraktor:	Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me adresë: Rruga "Sami Frashëri", nr. 10, Tiranë.
Subjekte të Interesuar:	Operatori ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK, me NUIS K37513520N, me adresë: Rruga Lezhë Lagjja "Skëndërbeg", godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë - Shkodër, km 1.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

1.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

1.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19.09.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit *"Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*", me Nr. REF-20524-09-18-2024 me objekt *"Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave te kontributit të përbashket-materiale mobilimi urban dhe gjelbërimi, Loti 4 (Faza III)*", me fond limit 125,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2. Në datën 21.10.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 23.10.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:
1. OE: "A l b G a r d e n" SHPK NUIS K37513520N, vlera 93,762,492.75 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 300.00. – I Kualifikuar
2. OE: "LEON KONSTRUKSION" SHPK NUIS K71820009I vlera 96,249,035 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 291.00. – I Kualifikuar
3. BOE "GJELBERIMI" SHPK NUIS K33810026R 13% & "I.D.K-KONSTRUKSION" SHPK NUIS K51408016J 87%, vlera 99,807,600 lekë pa tvsh.Totali i pikëve 282.00– I Kualifikuar
4. BOE "AGRO – KORANI" SHPK NUIS L13329801V 40% & " BE - IS SH.P.K" sh.p.k NUIS K71412003A 60% , vlera 115,476,500 lekë pa tvsh. Totali i pikëve 243.00– I Kualifikuar

II.4. Në datën 28.10.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE "Formular Njoftim - Fituesi Paraprak", për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 75, datë 04.11.2024, sipas së cili është piublikuar fitues operatori ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK.

II.5. Në datën 05.11.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 3238/2024 protokolli, me datë 06.11.2024 dhe me numër ankimi elektronik

A/2024/4748 e operatorit ekonomik “LEON KONSTRUKSION” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A l b G a r d e n” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 3238/3 prot., datë 06.11.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “LEON KONSTRUKSION” SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 3238/2024 prot., datë 05.11.2024.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 4040/1 prot., datë 13.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3238/4 prot., datë 18.11.2024, me objekt “*Vendim*” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues (Vendimi datë 13.11.2024 KSHA), ku konstatohet, se e ka **pranuar pjesërisht** atë.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “LEON KONSTRUKSION” SHPK, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “A l b G a r d e n” SHPK *“mbi kriteret 2.2. kapacitetit ekonomik dhe financiar . 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së pëllogaritur të kontratës.*

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori

ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës me nr. 4040/1 prot., datë 13.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 3238/4 prot., datë 18.11.2024, me objekt "*Vendim*" dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues (Vendimi datë 13.11.2024 KSHA), ku konstatohet, se e ka **pranuar pjesërisht** atë.

Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

"Në përmbushje të kriterit të mësipërm, 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Operatori ekonomik ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023) dhe kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar eshte 114,636,803 lekë.

Kërkesa për një xhiro vjetore më të madhe se dyfishi i fondit limit të kontratës (në vlerën 250,000,000 lekë në këtë procedurë) synon të garantojë që operatori ekonomik ka stabilitet dhe kapacitet financiar të mjaftueshëm për të përballuar detyrimet që lidhen me kontratën e prokurimit.

Në përmbushje të krieterit të mësipërm, OE: "Alb Garden" SHPK, me NUIS K37513520N ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Shtojcën 8" FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT". Referuar formularit përmbledhës, OE ka deklaruar si subjekt mbështetës OE "JUBICA" SHPK, me NUIS K265290011.

Për të vërtetuar këtë kriter, OE "Alb Garden" sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vertetim per xhiron e tre viteve te fundit per OE. "Alb Garden" shpk nga Ministria e Financave dhe Ekonomise me Nr.T11645030 date 16/10/2024 me vlerat:

1. 2023-A 114,636,803

2. 2022-A 108,886,800

3. 2021-A 75,358,027

Pasqyrat Financiare per vitet 2021,2022,2023 me shkrese te Ministrise se financave dhe ekonomisë me Nr.676 Prot. Date 28/03/2024, Nr.1283 Prot. Date 30/06/2023 dhe Nr. 502/1 Prot., datë 03/03/2024.

Vertetim per xhiron e tre viteve te fundit per OE. "JUBICA" shpk nga Ministria e Financave dhe Ekonomise me Nr.T11650368 date 16/10/2024 me vlerat:.

1.2023-A 278,055291

2. 2022-A 575,027,132

3. 2021-A 270,087,578

-Deklarate angazhimi me date 21/10/2024 si subjekt mbeshtetes, Shtojca 8 Formulari permbledhes I vetedeklarimit "JUBICA" shpk.

Referuar në nenin 90 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, në pikën 1 dhe 2 është parashikuar: 1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së. 2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

Per sa më sipër, ***pretendimi i subjektit ankues*** *se nga ana e operatorit ekonomik "Alb Gard e n" shpk nuk plotesohet kriteri 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar* ***eshte i drejte*** *pasi shuma per xhiron vjetore* ***nuk arrin vleren e kerkuar*** *të paktën 50% ose shprehur ne vlere 125,000,000 leke*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: "*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera".*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" i cili parashikon shprehimisht se : "*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*
a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:
i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.
2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës

1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Për sa më sipër citur, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1, të nenit 113, të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar, dhe do të vazhdojë shqyrtimin për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "LEON KONSTRUKSION" SHPK, duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK me arsyen se: "*2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së pëllogaritur të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

a) *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*
b) *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7/2 "*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*", pika 2.3.1 "*Kapaciteti teknik*", i dokumenteve standarde të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së pëllogaritur të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*
b) *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik *"A l b G a r d e n" SHPK*, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

	AlGarden SHPK			
Nr.	**Furnizime te ngjashme**	Vlera pa TVSH		
1	Kontratë me nr.361/12 prot., datë 02.06.2021 me objekt "Drurë dhe shkurre dekorative", lidhur midis operatorit ekonomik "AlbGarden" SHPK dhe autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh,	XXXXXX	pa tvsh	
	Faturë 29/2021 datë 08.11.2021	XXXXXX	pa tvsh	XXXXXX
	Situacion pregresiv			
	procesverbal marrje ne dorëzim të bimësisë dekorative	XXXXXX		
	Faturë 38/2021 datë 14.12.2021	XXXXXX		XXXXXX
	Situacion pregresiv			
	procesverbal marrje ne dorëzim të bimësisë dekorative	XXXXXX		
	Vërtetim realizim kontrate			
2	Kontratë me nr.108/13prot., datë 10.03.2022 me objekt "Drurë dhe shkurre dekorative", lidhur midis operatorit ekonomik "AlbGarden" SHPK dhe autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh,	XXXXXX	pa tvsh	
	Faturë 111/2022 datë 10.11.2022	XXXXXX	pa tvsh	XXXXXX
	Situacion pregresiv			
	procesverbal marrje ne dorëzim të bimësisë dekorative	XXXXXX		
	Faturë 142/2022 datë 14.12.2022	XXXXXX		XXXXXX
	Situacion pregresiv			
	procesverbal marrje ne dorëzim të bimësisë dekorative	XXXXXX		
	Vërtetim realizim kontrate			
3	Kontratë me nr. 179/3 prot., datë 02.02.2022 me objekt "Gjelbërimi në qytet", lidhur midis operatorit ekonomik "AlbGarden" SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh,	XXXXXX	pa tvsh	
	Faturë 6/2022 datë 02.03.2022	XXXXXX	pa tvsh	XXXXXX
	Situacion pregresiv			

	procesverbal marrje ne dorëzim të bimësisë dekorative	XXXXXX		
	Vërtetim realizim kontrate			
4	Kontratë me nr. 2542/26 prot., datë 13.10.2022 me objekt "F.V. Gjelbërimi në qytet", lidhur midis operatorit ekonomik "AlbGarden" SHPK dhe autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, me vlerë xxxxxxxx lekë me TVSh,	XXXXXX	pa tvsh	XXXXXX
	procesverbal marrje ne dorëzim të mallit	XXXXXX		
	procesverbal marrje ne dorëzim të mallit	XXXXXX		
	Vërtetim realizim kontrate			
	Fondi limit	125,000,000.00		XXXXXX
		40%		
		50,000,000.00		

III.2.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale.
Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.
Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.
Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.
Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.
Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të

njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër."
Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: "*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...*"

III.2.4. Në nenin 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave" pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se:*"3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

Në nenin 40 "*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave"* pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar,* parashikohet se:
4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kapacitetin teknik ka kërkuar shprehimisht që *" 2.3.a). Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë për të fituar kontratën publike. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi.
Nisur nga pretendimet e të operatorit ekonomik ankimues mbi mospërmbushjen e kriterit për vërtetimin e furnizimeve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit të përcaktuar në "kriteret e veçanta" të kualifikimit, "kapaciteti teknik" pika 2.3.1. të dokumenteve të tenderit, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK në lidhje me kontratat e ngjashme, KPP konstaton, se me

dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK ka plotësuar kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për sa i përket vërtetimit të realizimit të furnizimeve të ngjashme.
Konkretisht, KPP konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre si dhe përshkrimi i mallit të faturave tatimore të realizuara me ente publike, rezulton se konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, sipas tabelës së përcaktuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi. KPP pasi i veçoi këto kontrata dhe faturat tatimore zërat e të cilave mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit, vëren se vlera e tyre prej XXXXXX lekë arrin të përmbushë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK me dokumentacionin e paraqitur provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi jo të gjithë zërat e kontratave dhe faturave të paraqitura janë të ngjashëm me objektin e prokurimit, si dhe ato zëra të kontratave apo faturave që KPP i konsideroi si të ngjashëm me objektin e prokurimit mjaftojnë për të plotësuar vlerën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron furnizimet e mëparshme të ngjashme të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, kërkesë kjo e cila është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "LEON KONSTRUKSION" SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *"Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik",* Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe

funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "LEON KONSTRUKSION" SHPK, për procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*", me Nr. REF-20524-09-18-2024 me objekt *"Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave te kontributit të përbashket-materiale mobilimi urban dhe gjelbërimi, Loti 4 (Faza III)*", me fond limit 125,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 21.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "LEON KONSTRUKSION" SHPK për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit për operatorin ekonomik "A l b G a r d e n" SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke zbatuar Vendimin me datë 13.11.2024 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të autoritetit kontraktor.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "LEON KONSTRUKSION" SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
   Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	**Anila Malaj**	**Kreshnik Ternova**	**Gjergj Mersini**

Kryetar

Jonaid Myzyri

Digitally signed by
Jonaid MYZYRI
Date: 2024.11.21
05:16:00

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2024/11/21 16:54:33 +02'00'
bb3f221adc4f45d09a6f51575cee1fd52024112116542658020

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*